

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"LEKLIFARM GLOBAL"

Sot më date 01.07.2020, në Tiranë, ortaku i vetëm themelues:

Fatbardh Danja i biri i **Ismajl** – me datelindje 03.09.1971 lindur ne shkoder, I pajisur me pasaporte me nr B19529712.

Me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, në cilësinë e ortaku të vetëm të shoqërisë,.bazuar në legjislacionin shqiptar:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ;
- Ligji Nr. 9901,Dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- Ligji Nr. 9723,Dt. 03.05.2007 "Për Quendren Kombëtare të Regjistrimit"
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ;
- Si dhe gjithashtu bazuar në gjithë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë,

Harton kete statut të shoqërisë tregtare "LEKLIFARM GLOBAL " SHPK, e cila ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (sh.p.k), si një shoqëri e të drejtës shqiptare, e cila do të funksionojë në përputhje me ligjin shqiptar dhe përputhje me statutin, siç vendoset më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emërtimi I shoqërisë

Emërtimi I shoqërisë është "LEKLIFARM GLOBAL " SHPK, më poshtë e quajtur edhe "shoqëria".
Vendimi për emrin dhe emërtimin e shkurtuar të shoqërisë e merr Ansambleja e Shqipërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë "LEKLIFARM GLOBAL " SHPK, është në adresën : rruga njazi meka nr 47,pal 11,kati1,Tirane, Shqipëri.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj. Shoqëria mund të hapë filiale të tjera në rrethe të tjera të vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Kohëzgjatja e shoqërisë "LEKLIFARM GLOBAL " SHPK, do të jetë për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga momenti I regjistrimit të saj në QKB, Tiranë.



Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë tregtare "LEKLIFARM GLOBAL " SHPK

është :

- Produkte farmaceutike
- Importi dhe exporti I mallrave
- furnizuesit e përgjithshëm dhe menaxhimi biznesit

i cili do të zhvillohet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë këtë fushë.

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë Emërtimi, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë ortaku I vetëm.

Neni 6

Kapitali I shoqërisë

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 leke (një qind) dhe është përbërë nga 1 kuote.

Kapitali i lartpërmendur është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatësisht: zotërues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 100 leke, që përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali i themeltar mund të ndryshohet vetëm me vendimin e të ortakut të vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme në cdo formë qe parashikon ligji.

Neni 7

Drejtimin dhe administrimi

7.1 Shoqëria tregtare "LEKLIFARM GLOBAL " sh.pk është në pronë e ortakut të vetëm, Fatbardh Danja, I cili gëzon të gjitha atributet e asamblesë së shoqërisë.

7.2 Administrimi i shoqërisë kryhet nga administratori, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7.3 Administrator i shoqërisë është Fatbardh Danja.

7.4 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërisë dhe të drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me ligjet dhe aktet ligjore në Fuqi.Në mungesë të tij shoqëria administrohet nga përfaqësuesi ligjor me prokurë të noterizuar vetëm sipas tagreve të caktuar në prokurë.



Neni 8

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës.

Neni 9

Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare "LEKLIFARM GLOBAL " sh.p.k organizon kontrollin e brendshëm kontabël me ekspertë kontabël të autorizuar, i cili caktohen nga ortaku I vetëm.

Neni 10

Dispozita financiare

10.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Viti i pare nis nga data në te cilen shoqëria është njohur ligjërisht, deri me 31 dhjetor të po atij viti.

10.2 Me mbylljen së vitit financiar, administratori marrë masa për hartimin e bilancit të vitit financiar të mbyllur.

10.3 Për sa i përket kontabilitetit zbatohen rregullat e përcaktuara nga ligji shqiptar ne fuqi.

Neni 11

Trashëgimia

Pasuria e shoqërisë është lirisht e trashëgueshme në rrugë trashëgimie.

Neni 12

Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

Ne rastin e prishjes dhe likuidimit të shoqërisë do të zbatohen dispozitat e nr 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Neni 13

Ligji i aplikueshëm

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë statut.



Ky statut i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar hartohet në pesë (pesë) kopje në shqip me fuqi të njëjtë ligjore dhe nënshkruhen rregullisht nga partneri i vetëm themelues.

Neni 14

Dispozita të tjera

14.1. Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe aktet e tjera ligjore / nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

14.2. Mosmarrëveshjet eventuale gjate ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, ndërmjet ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve apo ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do te zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar dhe gjykate kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Nënshkruar

Fatbardh Danja

